

VENDIM
Nr. 463, datë 26.7.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 419, DATË 25.6.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE TË
POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPAVE A,
B DHE C, PËR TRANSFERIMIN E LEJEVE NGA NJË SUBJEKT TEK TJETRI, TË
KUSHTEVE PËR LEJET RESPEKTIVE TË MJEDISIT, SI DHE RREGULLAVE TË
HOLLËSISHME PËR SHQYRTIMIN E TYRE NGA AUTORITETET
KOMPETENTE DERI NË LËSHIMIN E KËTYRE LEJEVE NGA QKB-ja”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 419, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në titull dhe kudo në përmbajtjen e vendimit, togfjalëshi “A, B dhe C”/ “A, B ose C” zëvendësohet me “A dhe B”.

2. Kudo në përmbajtjen e vendimit:

a) emërtimet “Inspektoratin/it Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU)” dhe “Inspektoratin/it Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave” hiqen;

b) togfjalëshi “... në pikën 13, të kreut V ...” zëvendësohet me “... në pikën 13, të kreut VI ...”;

c) emërtimi “Ministria e Mjedisit” zëvendësohet me fjalët “... ministria përgjegjëse për mjedisin ...”.

3. Në kreun II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kërkuesi që aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, për pajisjen me leje mjedisi të tipit A, duhet të dorëzojë këto dokumente:”.

ii. Shkronja “c”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Çdo dokument tjetër i nevojshëm që vërteton deklaratimet në formularin informues, që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysht gjatë shqyrtimit të aplikimit;”.

b) Pas pikës 1.1 shtohen pikat 1.2 dhe 1.3, me këtë përmbajtje:

“1.2. AKM-ja brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit nga QKB-ja për leje mjedisi të tipit A shqyrton kërkesën dhe verifikon nëse dokumentacioni është depozituar saktë dhe i plotë sipas pikës 1, të këtij kreu. Në rast se konstaton se dokumentacioni i depozituar nga kërkuesi nuk është i plotë apo ka pasaktësi, e njofton atë përmes portalit “*e-Albania*”, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit dhe të pasaktësive të konstatuara, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga dita e njoftimit.

1.3. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit, të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila në këtë rast quhet se nuk është regjistruar. Kërkuesi njoftohet përmes portalit “*e-Albania*” për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet bashkë me aktet e tjera.”.

c) Pikat 2, 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. AKM-ja kur vlerëson se dokumentacioni është i plotë, sipas pikës 1, të këtij kreu, brenda 7 (shtatë) ditëve pune, ia përcjell atë institucioneve të mëposhtme, të cilat japin mendimin e tyre brenda 7 (shtatë) ditëve pune:

- a) Drejtorive teknike në ministrinë përgjegjëse për mjedisin, sipas specifikave të instalimit;
- b) Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM);
- c) Ministrive të linjës dhe strukturave të varësisë, sipas fushës së veprimtarisë që lidhen me specifikat e instalimit;

ç) Njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas juridiksionit territorial ku ndodhet instalimi.

3. Nëse institucionet e përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, nuk shprehen brenda afatit, AKM-ja vijon me procedurën e shqyrtimit të kërkesës për leje të mjedisit të tipit A.

4. AKM-ja pas mbledhjes së mendimeve nga institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij kreu, ose pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, harton brenda 10 (dhjetë) ditëve pune aktin e miratimit ose refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të tipit A, të shoqëruar me argumentet përkatëse dhe e dërgon te ministri.”.

ç) Në pikën 6, fjalët “... brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim ...” zëvendësohen me “... brenda 2 (dy) ditëve nga data e marrjes dijeni së aktit të miratimit ose refuzimit të lejes së mjedisit të tipit A ...”.

d) Në pikën 12, togfjalëshi “... është 60 (gjashtëdhjetë) ditë pune.” zëvendësohet me “... është 43 (dyzet e tre) ditë pune.”.

4. Në kreun III bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

i. Fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kërkuesi, që aplikon në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) nëpërmjet portalit “*e-Albania*” për pajisjen me leje mjedisi të tipit B, duhet të dorëzojë këto dokumente:”.

ii. Shkronja “c”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Çdo dokument tjetër i nevojshëm, që vërteton deklaratimet në formularin informues që kërkuesi i lejes kërkon të merret parasysht gjatë shqyrtimit të aplikimit;”.

b) Pas pikës 1.1 shtohen pikat 1.2 dhe 1.3, me këtë përmbajtje:

“1.2. AKM-ja brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit nga QKB-ja për leje mjedisi të tipit B shqyrton kërkesën dhe verifikon nëse dokumentacioni është depozituar saktë dhe i plotë, sipas pikës 1, të këtij kreu. Në rast se konstaton se dokumentacioni i depozituar nga kërkuesi nuk është i plotë apo ka pasaktësi, e njofton atë përmes portalit “*e-Albania*”, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit dhe të pasaktësive të konstatuara brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita e njoftimit.

1.3. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila, në këtë rast, quhet se nuk është regjistruar. Kërkuesi njoftohet përmes portalit “*e-Albania*” për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet bashkë me aktet e tjera.”.

c) Pikat 2, 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. AKM-ja kur vlerëson se dokumentacioni është i plotë, sipas pikës 1, të këtij kreu, brenda 5 (pesë) ditëve pune, ia përcjell atë institucioneve të mëposhtme, të cilat japin mendimin e tyre brenda 5 (pesë) ditëve pune:

- a) Drejtorive teknike në ministrinë përgjegjëse për mjedisin, sipas specifikave të instalimit;
- b) Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM);
- c) Ministrive të linjës dhe strukturave të varësisë, sipas fushës së veprimtarisë që lidhen me specifikat e instalimit;

ç) Njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas juridiksionit territorial ku ndodhet instalimi.

3. Nëse institucionet e përcaktuara në pikën 5, të këtij kreu, nuk shprehen brenda afatit, AKM-ja vijon me procedurën e shqyrtimit të kërkesës për leje të mjedisit të tipit B.

4. AKM-ja pas mbledhjes së mendimeve nga institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij kreu, ose pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, harton brenda 10 (dhjetë) ditëve pune

aktin e miratimit, refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të tipit B, të shoqëruar me argumentet përkatëse dhe e dërgon te ministri.”.

ç) Në pikën 6, fjalët “... brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim ...” zëvendësohen më togfjalëshin “... brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e marrjes dëni së aktit të miratimit ose refuzimit të lejes së mjedisit të tipit B ...”.

d) Në pikën 10, togfjalëshi “... është 40 (dyzet) ditë pune.” zëvendësohet me “... është 32 (tridhjetë e dy) ditë.”.

5. Kreu IV dhe seksioni 2, i kreut V, shfuqizohen.

6. Në kreun VI bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kërkuesi përpara aplikimit në QKB dërgon në AKM, në njësinë e vetëqeverisjes vendore (NJQV) dhe Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM), ku do të ketë vendndodhjen instalimi, një njoftim me shkrim dhe në formë elektronike për aplikimin që do të kryejë për t’u pajisur me leje mjedisore të tipit A ose B.”.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. AKM-ja publikon menjëherë në faqen e saj të internetit njoftimin, sipas pikës 2, të këtij kreu, për të paktën 20 (njëzet) ditë pune.”.

7. Pikat 2, 5, 6 dhe 7, të kreut VIII, shfuqizohen.

8. Shtojcat 3 dhe 6, bashkëlidhur vendimit, shfuqizohen.

II. Për të gjitha kërkesat e paraqitura përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi për t’u pajisur me leje mjedisi të tipit A ose B zbatohen dispozitat ligjore në fuqi në kohën e aplikimit.

III. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, agjencitë rajonale të mjedisit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku